

URDHËR
Nr. 75, datë 9.4.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikës V/2, germa “a”, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT

Eglantina Gjermani